



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština štrpce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Strpce



REPUBLICA E KOSOVES
OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHËRËPÇËS
IZLAZENI - DALJE
Nr. Prot. 01-020/08-2889/23
Nr. i fq. 1
Datum 06.03.2023
ŠTRPCE - SHËRËPÇË

Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 27/02/2023 miratoi këtë :

V E N D I M


Miraton procesverbal nga seanca e kuvendit e mbajtur me 26.01.2023

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic





Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republik of Kosovo

Skupstina opštine štrpce

Kuvendi i Komunës së Shtërpçës

Municipality of Strpce

PROCESVERBAL

Nga seanca e pestë e rregullt e KK-ës të mbajtur më 26.01.2023, me fillim në ora 10:00 h.

Rendi i ditës:

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar e K. K. Shtërpçës.**
- 3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për zyrën e prokurimit për vitin 2023**
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbajtjen e debatit publik për projekt-rregulloren për menaxhimin e mbeturinave.**
- 5. Raporti i Kryesuesit për zbatimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2022**
- 6. Të ndryshme.**

Seanca e filloi me punë pasi kryesuesi i Kuvendit, z. Predrag Grbic ka përshëndet të pranishëm, veçanërisht z. Miloradin Popovc, kryetari i e Këshillit Kombëtar Serb dhe deputeti i Kuvendit të Republikës së Kroacisë, znj. Jelena Nestotovic, përfaqësuese e Forumit Demokratik Serb, dhe z. Eugen Jakovic, përfaqësues i Këshillit Kombëtar Serb në Kroaci. Pas kësaj ka konstatuar se ka kuorum, pasi kanë qenë të pranishëm të 15 këshilltarët.

Slavisa Vasiljevic: Tha se priste që pika e parë e rendit të ditës të ishte shqyrtimi i situatës së sigurisë në komunën e Shtërpçës, duke qenë se të gjithë e dinë se çfarë ka ndodhur në ditën e Krishtlindjes, ku pati një sulm të armatosur, ku janë plagosur dy fëmijë. Ai kërkoi nga Kuvendi që të nxjerrë konkluzionin të qarta dhe një vendim lidhur me atë incident dhe kërkoi nga këshilltarët që këtë propozim ta mbështesin institucionalisht dhe që të jetë karakterit parandalues dhe të mos ndodhë më, sepse kjo ngjarje na shqetësoi të gjithëve që jetojmë këtu, si dhe të gjithë rajonin.

Dalibor Jevtic: Ai tha se ka planifikuar që të diskutohet për këtë temë, ku komuna ka mbajtur disa takime lidhur me atë incident, ku edhe qytetarët ju kanë drejtuar dhe kanë kërkuar takim me përfaqësuesit e fshatit, gjë që u bë dhe ata kërkuar që këto nuk duhet të jetë konkluzion politik, por kërkesat e qytetarëve që do të dorëzohen në institucionet kompetente dhe janë dorëzuar kërkesat të qytetarëve me gojë dhe me shkrim. Ai e përshëndeti iniciativën e këshilltarit.

Slavisha Vasiljevic: Ai ka qenë i mendimit që kjo të jetë pika e parë e rendit të ditës, pasi që edhe qytetarët kanë kërkuar diçka të tillë dhe që këshilltarët të përfaqësojnë qytetarët dhe se ky nuk është vendim politik dhe se komuna duhet të marrë vendime të qarta për këtë çështje dhe se si këshilltar priste seancë të jashtëzakonshme si dhe mbajtjen e takimit e KKS-së.

Dalibor Jevtic: Ai e ka mbështetur këtë, që të është pika e parë e rendit të ditës, dhe më pas z. Vasiljevic propozoi që kjo pikë të jetë: Shqyrtimi i situatës së sigurisë në komunën e Shtërpçës.

Ky propozim u miratua unanimisht.

Më pas i gjithë rendi i ditës u hodh në votim dhe u miratua unanimisht së bashku me propozimin që ishte dhënë më herët.

Më pas z. **Grbic** e vuri në votim procesverbalin dhe ai u miratua unanimisht.

Kryetari i Komunës së Shtërpçës, z. Dalibor Jevtic, në përputhje me propozimin a, i cili kishte të bënte me ngjarjen e pakëndshme në Gotovushë, ju ka drejtuar të pranishmëve, dhe mbi të gjitha e karakterizoi këtë ngjarje si një tentativë për të vrarë të një djalosh të ri dhe një djalit në një nga festat më të mëdha ortodokse. Ai u shpjegoi të pranishmëve se në radhë të parë i vinte gjithmonë kërkesat e qytetarëve dhe se për këtë, edhe pse ishte planifikuar më parë, nuk u thirr një seancë e jashtëzakonshme e KK dhe takimi i Komitetit për Siguri, kërkesat e qytetarëve të cilët në mënyrë spontane u mbledhën atë ditë ka qenë që të zhvillohej një takim gjithëpërfshirës sigurie me të dhe bashkëpunëtorët e tij.

Nga i gjithë ky diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, doli një përfundim gjithëpërfshirës që u miratua njëzëri nga të gjithë të pranishmit dhe në të thuhet:

Kuvendi i Komunës së Shtërpçës, Komuna e Shtërpçës, dhe të gjitha organet dhe institucionet e saj, njëzëri dhe pa dyshim dënojnë tentim vrasjen e Milosit dhe Stefanit Stojanovic, më 06.01.2023, dhe në të njëjtën kohë kërkon nga të gjitha institucionet kompetente për kujdesin dhe sigurinë e qytetarëve tanë, për t'iu përmbajtur kërkesave të mëparshme të qytetarëve të Komunës së Shtërpçës:

Që Policisë e Kosovës dhe KFOR-i, të shtojnë një prani më të madhe në të gjitha lokacionet që paraprakisht janë kërkuar me shkrim dhe në të njëjtën kohë u bëjmë thirrje të gjithë faktorëve dhe aktorëve relevant që të ndikojnë në mënyrë parandaluese, për të parandaluar në të ardhmen ngjarje të tilla dhe të ngjashme.

KK Shtërpçe gjithashtu vjen në përfundim se në territorin e komunës së Shtërpçës ekzistojnë marrëdhënie të mira ndëretnike dhe me dëshirën për shërim sa me të shpejt të Stefanit dhe Millosit nga lëndimet e tyre, le të jenë ata simboli dhe mesazhi i qartë për t'u kthyer drejt paqes

dhe bashkëjetesës, sepse kjo është mënyra e vetme për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët e komunës së Shtërpcës.

Shpejtim Arifi: Fillimisht dua të them se jam i lumtur sepse kanë shpëtuar ata fëmija dhe u uroj shërim sa më të shpejtë, si përfaqësues i shqiptarëve në komunën e Shtërpcës, publikisht e kam dënuar këtë plagosje dhe do të doja të bëj të njëjtën gjë këtu në organin më të lartë komunal. Dhe do të doja që ky rast të mos politizohet, është një rast i izoluar, është shumë fat i mirë që autori është arrestuar dhe po mbahet në paraburgim dhe duhet t'i lëmë organeve kompetente të vendosin për procedurat e mëtejshme deri në përfundim. Ky rast nuk ka ndikuar në marrëdhëniet tona të mira ndëretnike që i kemi ndërtuar prej disa vitesh.

Z. Vasiljevic shtoi se KK e Shtërpcës duhet të marrë një vendim për ndihmë materiale dhe çdo tjetër për Millosin dhe Stefanin Stojanovic.

Ky konkluzion u miratua me 11 vota pro dhe 4 abstenime. Pika tjetër ishte:

Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për zyrën e prokurimit për vitin 2023.

Në lidhje me këtë fjalën e mori **Slavisa Vasiljevic**, ku theksoi se nuk e përkrah buxhetin dhe se më herët kishte bërë një sërë kundërshtimesh ndaj buxhetit dhe tha se plani i prokurimit është i lidhur ngushtë me buxhetin dhe për të ky plan është e papranueshme në shumë segmente. Për të ishte i papranueshëm fakti që komuna mund të shpenzonte 18.000 € për telefona celularë, ai kishte kundërshtim edhe për shpenzimet e udhëtimeve zyrtare në vlerë prej 10.000 €, theksoi se është e panevojshme dhe se paratë mund të përdoren për ndonjë qëllim tjetër. Po ashtu, në planin e prokurimit është rregullimi i oborrit të stacionit e policisë dhe kjo për të ishte e pakuptueshme sepse stacioni është i MPB që është një institucion tjetër dhe nëse kjo është një humbje e panevojshme parash, duhet të rregullon MPB e Kosovës. Ai theksoi se kur nuk kemi ujë të pijshëm dhe kemi infrastrukturë shumë të keqe, po shpenzojmë para për diçka që duhet të bëjnë institucionet e tjera. Më tej, ai tha se komuna shpenzon 25 mijë euro për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave dhe u interesua të cilin parkun e veturave e kemi që duhet ta shpenzojmë atë shumë? Po ashtu komuna ndan rreth 3500 € për regjistrimin e automjeteve dhe 25000 € për mirëmbajtje dhe nëse 3500 € ndani me 250 € që është kostoja e regjistrimit të automjetit, del se komuna ka 10-15 vetura dhe si na e shpenzojmë 25.000 € për servisim, pyeti ai? Po ashtu, ai tha se është e papranueshme që komuna të përsërisë të njëjtat gabime për renovimin e spitalit ku janë ndarë 317 mijë euro. Ai vlerësoi se drejtori i shëndetësisë duhet të krijojë një plan veprimi në mënyrë që të paraqesë një dokument në të cilin do të tregohet periudhë kur komuna planifikon hapjen e spitalit. Ai ka përmendur se para disa ditësh ka ndodhur një grabitje në spital, dhe se çdo gjë që është grabitur dhe e shkatërruar duhet të rinovohet nga komuna, pas së cilës kryetari i ka thënë se është jashtë temës dhe pas kësaj z. Vasiljeviq, për të mos dalë jashtë temës, se plani i prokurimit parashikon që të shpenzohen ato mjete buxhetore prej 317,000€, që dështuan. Ai më tej tha se në vitin 2012 është bërë pranimi teknik i spitalit, por nuk është vënë asnjëherë në funksion, ka pyetur se kush e ka shkatërruar spitalin, me ç'rast kryesuesi e ka ndërprerë, duke pasur parasysh se koha e përcaktuar me rregulloren e punës, kishte kaluar

Dalibor Jevtic: theksoi se kur dikush nuk di diçka, duhet të informohet dhe fillimisht të shohë nëse ato informacione janë të vlefshme dhe se ka gjëra që i përcakton buxheti dhe pastaj bëhen planet në bazë të asaj që është miratuar. Ai ra dakord me kryesuesin që ka folur jashtë temës. Ai më tej tha se komuna ka një plan afatgjatë që parashihet aktivitetet dhe më pas realizohen projektet dhe theksoi se nuk ka rëndësi se policia është e ministrisë, por se ku ndodhet ai stacion policor.

Plani është që çdo pjesë e komunës sonë të rregullohet në mënyrë që vetë komuna të duket më mirë dhe me ministrinë kanë pasur marrëveshje se cilën pjesë do ta përfundojnë ata dhe cilën do ta përfundojnë ne, si komunë. Ai ka folur edhe për spitalin dhe është parashikuar se ideja është që spitali të vihet në funksion dhe kjo është e pamundur pa riparuar gjithçka që nevojitet, që nuk janë të funksionale dhe se plani është që spitali të futet në funksion brenda 2 viteve të ardhshme dhe ai tha që për këtë ka folur disa herë.

Po ashtu, ai tha se është kontrata në bazë të të cilës komuna duhet të ndajë mjete buxhetore dhe se kjo nuk ka të bëjë me gjëra të tjera dhe se kështu do të jetë deri në skadimin e kontratës. Ai iu drejtua z. Vasiljevicit i tha se duhet të lexojë ligjin dhe të njihet me procedurat dhe se para se të thotë diçka, të kupton se për çfarë po flet. Ai më tej theksoi se mund të realizohen vetëm ato projekte që kanë dokumentacion të plotë dhe për këtë arsye i kushtohet vëmendje e veçantë kur bëhet fjalë për projektet e reja, që të gjitha projektet infrastrukturore janë njësoj të rëndësishme kudo, pavarësisht nga vendi ku duhet të realizohen.

Slavisha Vasiljevic: Ai tha se ose nuk e kanë dëgjuar mirë atë që ka thonë ose i shqetëson mendimi i tij ndryshe. Ai po ashtu tha se plani i prokurimit lidhet drejtpërdrejt me buxhetin e miratuar. Ai theksoi se është i kënaqur kur dëgjon që spitali do të hapet në 2 vitet e ardhshme, mendoi se është e mundur, por përsëriti se panimi teknike për spitalin është bërë në vitin 2012. Ai theksoi se nuk do të kishte nevojë për renovime nëse dikush do të kishte ruajtur atë spital, sepse spitali me siguri do të ishte në gjendje të mirë. Ai ishte i mendimit se për dy vit spitali nuk mund të jetë funksional, në aspektin teknik, aspak në aspektin personel, ku theksoi gjithashtu se specializimi për një mjek zgjat pesë vite, dhe nëse thua se do të bëhet për 2 vite, atëherë nuk është serioze, ku në fund të prezantimit të tij ai përshëndeti lajmin që dëgjoji nga kryetari i komunës se spitali do të hapet për 2 vite.

Dalibor Jevtic: Kryetari i komunës iu drejtua z. Vasiljevicit, ku i tha të mos flasë për gjëra që nuk i di dhe se po mundohet të jetë më i zgjuar se të gjithë këtu. Ai theksoi sërish se nëse të gjitha procedurat dhe rrethanat e tjera na lejojnë të përgatisim spitalin për vënie në punë, është planifikuar të bëhet në 2 vitet e ardhshme, për ta bërë atë fizikisht të mundur, dhe proceset e tjera që lidhen me personelin dhe si do të funksionojnë shëndetësia sekondare, është çështje e ekspertëve dhe gjithçka tjetër që është në dorë të komunës do të bëhet. Ai ka theksuar se këshilltari nuk duhet të rrotullon fjalët e tij dhe të fol në atë mënyrë që i përshtatet.

Kryesuesi e vuri në votim këtë pikë.

Ai u miratua me 12 vota për 2 kundër 1 abstenim

Më pas kaloi në pikën tjetër të rendit të ditës:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbajtjen e debatit publik për Projekt rregulloren për menaxhimin e mbeturinave

Sinisha Buduric: Theksoi se kjo pikë është obligim ligjor për çdo komunë dhe nëse ka pyetje, ai është aty për t'iu përgjigjur.

Slavisha Vasiljevic: Tha se ky draft rregullore është përgatitur nga organizata gjermane GIS dhe është interesuar nëse ndonjë nga përfaqësuesit e komunës apo OJQ-së ka marrë pjesë në hartimin e këtij drafti?

Sinisha Buduric: Ekspertët e menaxhimit të mbeturinave nga GIZ kanë punuar në këtë, dhe drafti është i njëjtë për të gjitha komunat në Kosovë. Pas kësaj, kjo pikë u hodh në votim

Ai u miratua unanimisht

Pika tjetër ishte:

Raporti i Kryesuesit për zbatimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2022.

Z. Grbic: Shkurtimisht e prezantoi raportin, duke theksuar se në materialin që kanë marrë kanë të dhëna dhe vetëm shtoi se janë mbajtur 10 seanca të rregullta dhe 1 seanca të jashtëzakonshme. Askush nuk u lajmëruar për fjalë dhe kjo pikë nuk votohet, kështu që kaluam në pikën e fundit të rendit të ditës, që ishte pika:

Të ndryshme

Shpejtim Arifi: Dëshiroj të paraqes këtu kërkesën e banorëve të Bitis së Poshtme, për rregullimin e rrugës deri te varrezat. Në vitet e mëparshme rruga për në kishë ishte e asfaltuar dhe ajo rrugë mund të vazhdojë deri në varrezat e komunitetit shqiptar, kjo është shumë e rëndësishme, sepse deri atje mund të arritët disi, por sa herë që kam rast vdekjes vijnë njerëz nga jashtë, për të vajtuar për të ngushëlluar, rruga është e pakalueshme. Makinat nuk mund të kalojnë dhe është e vështirë të ecësh në këmbë dhe do të ishte mirë nëse mund ta vendoseni atë projekt përpara.

Dalibor Jevtic: Ai u përgjigj se ajo do të respektohet dhe se do të grumbullohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm që të mundësohet që të realizohet ky projekt.

Valmir Ahmeti: Dëshiroj të paraqes një kërkesë nga banorët e lagjeve Markaj, Sheler dhe Ogushaj, kanë ndërtuar një objekt që do të përdoret për nevojat e banorëve të atyre vendbanimeve, shoqata e grave, kërkesa e qytetarëve është që Komuna kontribon në rregullimin e oborrit, asfaltimin e oborrit dhe kërkojnë nga komuna nëse ka mundësi të ndërhyjë dhe ta shtrojë atë oborr.

Dalibor Jevtic: Ai u përgjigj se praktika do të vazhdojë edhe në të ardhmen për të gjitha çështjet, do të përcaktohen prioritetet dhe do të përkrahet nga komuna, aq sa e lejon buxheti.

Slavisha Vasiljevic: Ai tha se në komunën tonë ka pasur stuhi dhe se me atë rast në rrugën Jazhincë-Sevcë ka rënë një druri, një pjesë e drurit është hequr, por një pjesë e rrugës ka mbetur e mbuluar me degë dhe me atë rast ai bëri apel për ta hequr atë.

Drejtori i shërbimeve publike i tha se nuk ishte problem dhe se ajo do të zgjidhet.

Më pas kryetari i komunës përshëndeti të ftuarit ku i tha z. Pupovacit se kishte mundësinë të njihej me mënyrën se si bëhen punët këtu dhe të dëgjonte disa nga problemet tona dhe shfrytëzoi rastin për ta falënderuar për vëmendjen që i kushtoi, për praninë e tij dhe theksoi se do të jetë kënaqësi për të gjithë nëse na drejtohet këtu në Kuvend.

Në fund të kësaj seancës, këshilltarëve të pranishëm ju ka drejtua profesori Milorad Pupovac, i cili tha se edhe ai, sikurse kolegët e tij, është jashtëzakonisht i nderuar nga mundësia për të marrë pjesë në punimet e Kuvendit, „ Jam veçanërisht i nderuar që kemi mundësinë. t'ju përshëndes dhe të ndaj me ju disa fjalë duke u bazuar në përvojën time nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, solidaritetin tonë me ju që jetoni këtu në zonën e komunës së Shtërpçës.

“Nuk keni qenë të vetmit të shqetësuar nga ngjarjet e 6 janarit të këtij viti”. Nga ajo ngjarje janë shqetësuar të gjithë njerëzit që duan paqe dhe siguri në territorin e Kosovës dhe në territorin e komunës juaj”.

Profesor Pupovac tha gjithashtu, të besojmë se do të jetë ashtu siç dëshironi të gjithë ju të pranishëm këtu, këshilltarët dhe të gjithë në administratën komunale të qytetit dhe se njerëzit përgjegjës që udhëheqin institucionet kompetente të Kosovës, do ta realizojnë pikërisht këtë.

“Sepse për gjithçka që jetoni sot dhe për gjithçka që ju pret nesër, është e padiskutueshme që të ruhet paqja dhe të garantohet siguria për çdo qytetar që jeton në territorin e komunës së Shtërpçës dhe të gjithë Kosovës.

“Ju jam mirënjohës të gjithëve, pavarësisht nga cili komunitet vini, për krijimin e një atmosfere tolerance këtu në Shtërpçë dhe për format e komunikimit që garantojnë se do të nxisni paqen dhe do të arrini sigurinë, duke krijuar në të njëjtën kohë një vetëqeverisje lokale funksionale dhe efikase. Ju kujtoj se ne në Kroaci kaluam dhe ende kalojmë në të njëjta problem, ndonjëherë disa gjëra nuk zgjidhen shpejt dhe lehtë, ka gjithmonë njerëz që në një farë mënyre kthehen në mënyrat e vjetra, ose nuk mund të shikojnë mjaft mirë se si të bëjnë dhe të ndërtojnë një jete e mire. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që unë të besoj në atë që mund të arrini. Të kesh besim dhe vullnet të mirë dhe se, sidomos në rrethanat e sotme, kur kërkohen zgjidhje që në një farë mënyre do t'ju çlirojnë nga pasiguritë e viteve që keni jetuar dhe dëshirat që do të jenë në përputhje me atë që mund të garantojë stabilitet, paqe, funksionalitetin dhe, natyrisht, barazinë në marrëdhëniet e ndërsjella, në të cilat secili prej jush do të kontribuojë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë”. - tha Pupovci.

Pas kësaj seanca e KK-ës ka përfunduar

Procesmbajtësi

Staja Markovic

Kryesuesi i K.K.

Predrag Grbic